



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË


Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 60

Tiranë – E hënë, 27 mars 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 9, datë 21.3.2017	Për disa ndryshime në vendimin nr. 45, datë 19.9.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte, thirrja III e grantit “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi “Zhvillimi i infrastrukturës vendore dhe rajonale”, shtylla I, për vitin 2016”..... 3445
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 10, datë 21.3.2017	Për disa ndryshime në vendimin nr. 46, datë 19.9.2016 “Për shpërndarjen e financimit për projekte rajonale, thirrja I për vitin 2016, të drejtimit “Kohezioni territorial dhe zhvillimi rajonal”, të grantit “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi “Zhvillimi i infrastrukturës vendore dhe rajonale”, shtylla I”..... 3447
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 11, datë 21.3.2017	Për detajimin e fondit për programin e zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2017..... 3448
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 12, datë 21.3.2017	Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja I për vitin 2017, të grantit “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I..... 3449
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 13, datë 21.3.2017	Për shpalljen e thirrjes për propozime për përgatitje projektesh (projektim), nga granti “Infrastruktura vendore dhe rajonale” programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I, për vitin 2017..... 3452
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 15, datë 21.3.2017	Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja I për vitin 2017, granti “Arsimi”, programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I..... 3457






QARKU GJIROKASTËR						
4	Bashkia Tepelenë	Rikonstruksion i rrugës “Ago Celi”, rrugës së re dhe rikonceptimi i palestrës së lagjes “15 Shtatori”	146 841 855	146 841 855	140 470 869	6 370 986
QARKU VLORË						
5	Bashkia Vlorë	Rikonstruksion i rrugëve “Zigur Lelo” dhe “Shefit Zeno”	103 644 532	103 644 532	80 511 938	23 132 594
6	Bashkia Selenicë	Rikualifikim urban i lagjeve të fshatit Kote, Selenicë, loti I	62 916 997	62 916 997	60 907 032	2 009 965
7	Bashkia Vlorë	Rikonstruksion “Ura e Zvërnecit”, Nartë, Vlorë	36 804 961	36 804 961	32 935 419	3 869 542
8	Bashkia Vlorë	Rehabilitim i rrugëve “Ramize Gjebrea” dhe “Gjon Bocari”, loti I	80 458 119	80 458 119	59 393 880	21 064 239
9	Bashkia Vlorë	Rehabilitim dhe asfaltim i disa akseve kryesore të qytetit të Vlorës	149 819 543	149 819 543	108 224 716	41 594 827
TOTALI			879 348 771	879 348 771	775 656 055	103 692 716

Shënim:

1. “Vlera e projektit” përfaqëson vlerën e projektit të miratuar me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
2. “Vlera e kontratës” përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues, për zbatimin e punimeve të projektit mbas lidhjes së kontratës dhe “korrektion” vlerën e projektit.
3. “Vlera e financimit për vitin 2016” tregon vlerën e shpërndarë si financim për vitin 2016, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
4. “Vlera e kursyer pas lidhjes së kontratës” përfaqëson vlerën e përfutur nga diferenca ndërmjet vlerës së projektit dhe vlerës së kontratës, komunikuar nga Sekretariati Teknik pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, me shkresë nr.1744, prot., datë 17.3.2017 Fondi i krijuar nga kjo diferencë përfshihet në grantin “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, për vitin 2016 dhe kërkohet miratim i Ministrisë së Financave për “trashëgimin” dhe përdorimin e tij në vitin 2017.



**Shënim:**

1. “Vlera e projektit” përfaqëson vlerën e projektit të miratuar me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
2. “Vlera e kontratës” përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues, për zbatimin e punimeve të projektit mbas lidhjes së kontratës dhe “korrektion” vlerën e projektit.
3. “Vlera e financimit për vitin 2016” tregon vlerën e shpërndarë si financim për vitin 2016, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
4. “Vlera e kursyer pas lidhjes së kontratës” përfaqëson vlerën e përfituar nga diferenca ndërmjet vlerës së projektit dhe vlerës së kontratës, komunikuar nga Sekretariati Teknik pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, me shkresë nr.1744, prot., datë 17.3.2017. Fondi i krijuar nga kjo diferencë përfshihet në grantin “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, për vitin 2016 dhe kërkohet miratim i Ministrisë së Financave për “trashëgimin” dhe përdorimin e tij në vitin 2017.

VENDIM

Nr. 11, datë 21.3.2017

**PËR DETAJIMIN E FONDIT PËR
PROGRAMIN E ZHVILLIMIT TË
INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE
RAJONALE, SHTYLLA I, PJESË E
FONDIT PËR ZHVILLIMIN E
RAJONEVE, PËR VITIN 2017**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 16 dhe të aneksit 3, të ligjit nr. 130, datë 15.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Fondi prej 1 935 718 236 (një miliard e nëntëqind e tridhjetë e pesë milionë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë) lekë, i disponueshëm për financimin e projekteve të reja në vitin 2017, nga programi buxhetor “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, në buxhetin e Ministrisë së Zhvillimit Urban, alokohet në grante/programme si më poshtë:

a) 1 235 718 236 (një miliard e dyqind e tridhjetë e pesë milionë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë) lekë, për grantin “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I;

b) 300 000 000 (treqind milionë) lekë, për grantin për inovacionin dhe teknologjinë e komunikimit, programi “Shqipëria dixhitale”, shtylla II;

c) 400 000 000 (katërqind milionë) lekë, për grantin “Nënprogrami i mbështetjes financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM-të), programi i Mbështetjes për Ekonominë, shtylla III.

2. Ngarkohen ministri i Financave, ministri i Zhvillimit Urban, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Edi Rama**

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

**VENDIM****Nr. 12, datë 21.3.2017**

**PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT
PËR PROJEKTE TË REJA, THIRRJA I PËR
VITIN 2017, TË GRANTIT
“INFRASTRUKTURA VENDORE DHE
RAJONALE”, PROGRAMI I ZHVILLIMIT
TË INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE
RAJONALE, SHTYLLA I**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 dhe të aneksit 3, të ligjit nr. 130, datë 15.12.2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja I për vitin 2017, për grantin “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, me burim financimi buxhetin e projekteve të reja për vitin 2017, nga programi buxhetor “Infrastruktura Vendore dhe Rajonale” pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, sipas tabelës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të gjitha autoritetet kontraktuese, projektet e të cilave miratohen për financim sipas pikës 1 të këtij vendimi, brenda një jave nga data e publikimit të tij në Fletoren Zyrtare, duhet të paraqesin në sekretariatën teknik, pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, kalendarin me të gjitha afatet e parashikuara për fazat e prokurimit publik dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit, si dhe të përdorimit të fondeve dhe emrin e personit përgjegjës për informimin periodik.

3. Autoritetet kontraktuese për projektet, sipas pikës 1 të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së

kontratës përkatëse për zbatimin e punimeve të ndërtimit, përpara fundit të tremujorit të dytë, të vitit 2017. Për fondet e projekteve të paprokuruar sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtë të rishqyrtojë financimin dhe t'i rishpërndajë ato, për një projekt tjetër.

4. Ngarkohet sekretariati teknik, pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, të kryejë monitorimin e ecurisë së përdorimit të fondeve, sipas kalendarit të paraqitur nga autoritetet kontraktuese, në përputhje me pikën 2 të këtij vendimi dhe të informojë Ministrinë e Financave dhe periodikisht Komitetin për Zhvillimin e Rajoneve, përmes Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

5. Ngarkohen ministri i Financave dhe ministri i Zhvillimit Urban, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Edi Rama**

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.



Tabela 1 Lista e projekteve të reja, thirrja e I për vitin 2017, për grantin “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, me cikël zbatimi 2017-2018

Nr	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2017 (në lekë)
QARKU SHKODËR				
1	Bashkia Malësi e Madhe	Rikualifikimi i qendrës Bajzë Kastrati, loti I	100 000 000	30 000 000
2	Bashkia Vau i Dejës	Rikonstruksioni i rrugës Hajmel-Dheu i Lehtë-Pistull, loti I	100 000 000	30 000 000
QARKU KUKËS				
3	Bashkia Tropojë	Rikualifikimi i fasadave të objekteve, qyteti Bajram-Curri	41 900 720	12 570 216
QARKU DURRËS				
4	Bashkia Durrës	Rikualifikimi i hapësirave midis Kuartallit nga rruga "Skënderbej" deri në rrugën "Mars 91" e hapësira deri tek rruga e Portit, loti II	107 494 636	32 248 391
5	Bashkia Shijak	Rikonstruksioni rrjetit rrugor të Bashkisë Shijak, loti I	100 000 000	30 000 000
QARKU TIRANË				
6	Bashkia Tiranë	Korsi biçikletash në rrugën e Kavajës dhe rrugën e Dibrës	37 867 243	18 933 622
7	Bashkia Tiranë	Ndërtim dhe rikonstruksion i rrugës që lidh rrugën "Reshit Petrela" me rrugën "Skënder Kosturi" (paralel me rrugën "Jordan Misja")	55 130 948	27 565 474
8	Bashkia Kavajë	Rikonstruksioni i rrugës KLA&XHU - Shëtitore Qëndër Golem	77 970 252	23 391 076
9	Bashkia Rrogozhinë	Rikonstruksion i rrugëve të brendshme në Rrogozhinë (faza II dhe III)	149 822 191	37 455 548
QARKU ELBASAN				
10	Bashkia Përrenjas	Rikonceptim i qendrës së qytetit dhe rikonstruksioni i fasadave të qytetit Përrenjas	92 729 303	27 818 791
11	Bashkia Elbasan	Rikonstruksioni i rrugës rajonale Gostimë-Tregan, loti I	146 000 000	43 800 000
12	Bashkia Elbasan	Rikualifikimi urban i parkut qendror "Rinia"	250 000 000	25 000 000
13	Bashkia Belsh	Rikualifikimi urban i fasadave të qendrës Belsh	17 161 281	17 161 281
QARKU FIER				



14	Bashkia Divjakë	Rikonstruksion dhe zgjerim i rrugës Divjakë-Gërmenj, N.J.A. Divjakë	158 623 111	39 655 778
15	Bashkia Fier	Rikonstruksion i rrugës "Pishëporo-Bregdet", N.J.A. Levan	99 985 595	29 995 679
16	Bashkia Roskovec	Sistemim, asfaltim i rrugës Suk 1-Arapaj-Samaticë	194 574 979	58 372 494
17	Bashkia Lushnje	Sistemim, asfaltim i rrugës Bubullimë Imsht	78 346 951	39 173 476
18	Bashkia Lushnje	Ndërhyrje polifunksionale në lagjen "Xhevdet Nepravishta", loti I	139 523 830	41 857 149
QARKU BERAT				
19	Bashkia Poliçan	Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës Prokucë-Bodurë-Kapinovë, loti I	120 000 000	30 000 000
QARKU KORÇË				
20	Bashkia Maliq	Rivitalizimi i fshatit Sovjan dhe Luadishtë, përmes përmirësimit të infrastrukturës rrugore	99 800 000	29 940 000
21	Bashkia Korçë	Ndërtim i "Parkut japonez dhe kopshteve të komunitetit"	79 909 597	23 972 879
22	Bashkia Korçë	Rikonstruksion i ish-godinës së fonderisë, si projekt katalizator për zhvillimin ekonomik rajonal	86 265 659	34 506 264
QARKU VLORË				
23	Bashkia Himarë	Rikonstruksion i rrugës Kthesa e Pilurit (Himarë)-Vumblo	166 965 140	41 741 285
24	Bashkia Finiq	Rehabilitimi i rrugës Pllakë-Kulluricë	133 662 865	33 415 716
25	Bashkia Vlorë	Rikualifikimi i bllokut të banesave kufizuar nga rrugët "Bulevardi Çamëria", rruga "Pelivan Leskaj", "Bulevardi Pavarësia" rruga "Kujtim Beqiri-Pirro Sava"	91 331 230	45 665 615
26	Bashkia Vlorë	Rikualifikimi i bllokut të banesave kufizuar nga rrugët "Bulevardi Çamëria", rruga "Pelivan Leskaj", rruga "Ibrahim Abdulai", rruga "Kujtim Beqiri-Pirro Sava"	79 814 508	39 907 254
27	Bashkia Konispol	Rijetëzimi i ansamblit urban të qendrës Konispol	78 312 873	23 493 862
QARKU GJIROKASTËR				
28	Bashkia Këlcyrë	Rijetëzimi i pedonaleve dhe hapësirave rekreative në sheshin qendër	148 908 841	37 227 210
29	Bashkia Dropull	Mbi ndërtimin e rrjetit rrugor "Unaza e Pogonit", loti I	140 000 000	22 175 593
30	Bashkia Libohovë	Rikonstruksion i rrugës Kthesë e Nepravishtës - Fushë Nepravishtë	17 908 818	8 954 409



AGJENCI ZHVILLIMI RAJONAL				
31	AZHR 2	Përmirësimi i transportit dhe infrastrukturës ndërlidhëse Qaf Shtamë (Bashkia Krujë) - Burrel (Bashkia Mat), me qëllim promovimin e atraksioneve turistike të Parkut Kombëtar të Qafshamës (loti II.1) (infrastrukturë rrugore me interes të veçantë zhvillimi)	133 143 184	33 285 796
32	AZHR 3	Rigjallërimi i vlerave historike, kulturore e turistike të Zonës së Zhvillimit Rajonal 3, Korçë, Elbasan (3 lote)	148 133 524	37 033 381
33	AZHER	Qëndër multifunksionale e shërbimeve për sipërmarrjet e reja	98 000 000	29 400 000
TOTALI			3 569 287 279	1 035 718 236

Shënim:

1. “Vlera e projektit” përfaqëson vlerën e financimit për projektin, miratuar me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
2. “Vlera e financimit për vitin 2017” është financimi që jepet për vitin 2017, me burim fondin për projekte të reja të programit buxhetor “Infrastruktura vendore dhe rajonale” të Ministrisë së Zhvillimit Urban, për vitin 2017.
3. Likuidimi financiar për vlerën e projektit (ose për vlerën e kontratës pas prokurimit publik) në vitet në vazhdim do të kryhet nga Ministria e Zhvillimit Urban, duke u bazuar edhe në ecurinë e zbatimit dhe të realizimit të projekteve, programuar në buxhet me shtrirje në 2-3 vite.
4. Për projektet e financuara më sipër, ku do të ndërhyhet në zona me rëndësi për trashëgiminë kulturore, autoritetet kontraktuese do të zbatojnë projektet në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Institutin e Monumenteve të Kulturës, në përputhje me ligjin nr.9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”.

VENDIM

Nr. 13, datë 21.3.2017

**PËR SHPALLJEN E THIRRJES PËR
PROPOZIME PËR PËRGATITJE
PROJEKTESH (PROJEKTIM), NGA
GRANTI “INFRASTRUKTURA VENDORE
DHE RAJONALE” PROGRAMI I
ZHVILLIMIT TË INFRASTRUKTURËS
VENDORE DHE RAJONALE, SHTYLLA I,
PËR VITIN 2017**


Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 dhe të aneksit 3, të ligjit nr. 130, datë 15.12.2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpalljen e thirrjes për propozime për përgatitje projektesh (financim për fond për projektim), sipas programeve dhe granteve si më poshtë vijon:

1.1 Granti “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I.

2. Aplikimi për propozim për përgatitje projektesh, sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet nga Agjencia Kombëtare për Zhvillimin Rajonal, agjencitë për zhvillimin rajonal nr. 1, nr. 2, nr. 3 dhe nr. 4 dhe nga Agjencia për Zhvillimin Ekonomik Rajonal, sipas afatit dhe formularit në shtojcën I dhe shtojcën II, bashkëlidhur këtij vendimi.





Shtojcë II: FORMATI I APLIKIMIT PËR PROPOZIMIN PËR PËRGATITJE PROJEKTESH

Propozuesi	
Data e propozimit	
Titulli i propozimit	
Shtylla e financimit/grant	Të përcaktohet për cilën shtyllë aplikohet (sipas aneksit 3, të ligjit nr.130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”), sipas pikës 1 të vendimit.
Qëllimi dhe objektivat e propozimit për përgatitje projektesh	- Përkrahuesi shkurtimisht qëllimin e ndërhyrjes që propozohet të hartohet, potencialin rajonal që ajo adreson, si dhe argumentimin sesi ky propozim do t’ju përgjigjet mundësive për zhvillim të identifikuar për rajonin e zhvillimit ku shtrihet; - Listoni objektivat e mundshëm që synohen të arrihen me hartimin e këtij propozimi për përgatitje projektesh, drejtimit prioritar dhe masat 2017 – 2018¹, në arritjen e të cilave mendohet se kontribuon ai.
Përshkrimi i propozimit të pritshëm, për përgatitje projektesh	Të bëhet përshkrim i përgjithshëm i propozimit për përgatitje projektesh për t’u hartuar, duke përmbytur informacionin e mëposhtëm, por jo vetëm: - Lidhjen e propozimit, projektit/projekteve potenciale që mendohet të hartohen, me strategjinë territoriale dhe të zhvillimit të njërive vendore, Planin e Përgjithshëm Kombëtar, Programin Operacional, kuadrin strategjik për zhvillim; - Objektivat tematik që priten të arrihen me ndërhyrjen në fjalë, potencialin rajonal të identifikuar për zhvillimin e të cilit do të hartohen projektet; - Vendndodhjen e territorit dhe shtrirjen ose lidhjen rajonale ku parashikohet ndërhyrja e projekteve të mundshme të propozimit, duke specifikuar njësitë vendore brenda rajonit të zhvillimit, fondi për përgatitjen e të cilave kërkohet në këtë propozim tuajin (shoqëruar me hartë); - Partnerët potencialë me të cilët mund të punoni për zbatimin e ndërhyrjes, në nivel qendror, vendor apo partnerët e huaj për zhvillim.
Konteksti i zhvillimit rajonal, integrimi/agregimi dhe partneriteti rajonal	- Përkrahuesi nëse propozimi për ndërhyrje për përgatitje projektesh që mund të hartohen lidhet me projekte të tjera të financuara më parë nga FZHR-ja etj., rëndësia komplementare e investimit të pritshëm, lidhja me një ose disa nga masat 2017/2018 për arritjen e të cilave do të kontribuojnë ndërhyrjet e pritshme nga këto projekte potenciale; - Përkrahuesi nëse projektet potenciale që mund të zhvillojë propozimi integrojnë zbatimin e dy ose më shumë drejtimeve

¹ Miratuar me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, nr. 3, datë 9.2.2017 “Për drejtimit prioritar të politikës dhe kalendarin e programeve të financimit të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, për vitin 2017”.



	prioritare, masave 2017 – 2018 (e preferueshme) apo mund të jenë me financim të pritshëm që agregon burimin e financimit nga një ose më shumë grante njëherësh dhe/ose disa partnerë (e preferueshme).
Bashkitë dhe përfituesit	Jepni bashkitë, qarqet dhe partnerët e mundshëm që mendohet se mund të përfitojnë drejtpërdrejtë dhe tërthorazi nga zbatimi i propozimit, qytetet, fshatrat, kategoritë e përfituesve potencial.
Rezultatet e pritshme	Përshkruani rezultatet e pritshme, nëse financohet propozimi për përgatitje projektesh.
Kohëzgjatja e përgatitjes së propozimit	Jepni një kohë të mundshme, të pritshme për përgatitjen e paketës së projekteve që propozohet të hartohet, në rast financimi.
Koha e pritshme e fillimit të zbatimit të projekteve	Jepni të dhëna indikative si më poshtë: - Kohën e pritshme kur mendohet se mund të fillojë zbatimi i projekteve që mund të financohen për përgatitje; - Fondin e pritshëm të investimit për zbatimin e projekteve që mund të financohen për përgatitje.
Partnerë të tjerë potencial, me të cilët do të ndërtohet bashkëpunimi/bashkëfinancimi	Jepni partnerët në zbatimin e projekteve me të cilët potencialisht synoni të punoni për të ngritur fonde për bashkëfinancim në zbatim (nga njësitë qendrore, njësitë vendore apo nga donatorë, listoni bashkëfinancuesit e mundshëm).
Fondi që kërkohet për përgatitjen e projekteve rajonale (fondi i projektimit)	Jepni shumën totale të financimit për fond për përgatitje projektesh (financimi i projektimit) që kërkohet nga aplikuesi.
Deklarime	Aplikuesi deklaron se: - Llogaritja e tij është bërë në përputhje me aktet ligjore të zbatueshme.

Shënim:

Aplikuesi duhet të dorëzojë pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, së bashku me këtë formular të plotësuar edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- Dokument dakordësie në parim (ose Memorandum Mirëkuptimi) midis tij dhe/ose bashkive, ku mund të shtrihen projektet potenciale që mund të financojë ky fond për përgatitje projektesh (fondi i projektimit), dhe/ose partnerë të tjerë potencial;
- Listë indikative projektesh potenciale që mund të financojë ky fond për përgatitje projektesh (fondi i projektimit).



**Shtojca III: KRITERET E VLERËSIMIT TË PROPOZIMEVE PËR PËRGATITJE
PROJEKTESH (Shtylla I, Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe
Rajonale, granti “Infrastruktura vendore dhe rajonale”)**

Këto kriterë përdoren nga sekretariati teknik për të vlerësuar propozimin për financim me fond për përgatitje projektesh (financimi i projektimit) dhe në bazë të tyre kryhet **vlerësimi, maksimalisht, me 100 pikë**, i propozimit për financim/miratim nga Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

Kriteret detajohen në nënkriteret përkatëse nga sekretariati teknik i ngritur pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, sipas aneksit 3, të ligjit nr.130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”.

Kriteret/kërkesat e domosdoshme për të kualifikuar për vlerësim një propozim, i përcakton sekretariati teknik.

Kriteret për vlerësimin e propozimeve për financim me fond për përgatitje projektesh (financimi i projektimit) janë, si më poshtë vijon:

1. Projektet që do të hartohen nga ky financim të jenë projekte rajonale dhe të synojnë nxitjen e partneritetit për zhvillimin rajonal: ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 40 pikë**.

Ky kriter duhet kuptuar si, projektet që do të hartohen nga aplikuesit, kanë karakter më të theksuar rajonal/ndër-rajonal dhe jo të konceptuara vetëm si projekte ndërvendore midis dy apo më shumë bashkive.

2. Propozimi tregon se projektet që synohen të hartohen janë në përputhje me drejtimit prioritarë dhe masat për vitin 2017-2018 dhe kontribuojnë në arritjen e tyre: ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 30 pikë**.
3. Niveli i bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes qendrore ose vendore dhe fondet e partnerëve për zhvillim në fazën e zbatimit të tyre: ky kriter vlerësohet me **0 deri në, maksimalisht, 30 pikë**.

Ky kriter duhet kuptuar si, aplikuesit të identifikojnë ndërhyrje (përmes projekteve rajonale), të cilat arrijnë të gjejnë mbështetje dhe ngrajnë fonde për financimin e zbatimit të tyre dhe nga partnerë të tjerë qendror, rajonal, vendorë apo të huaj për zhvillim.

**VENDIM****Nr. 15, datë 21.3.2017**

**PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT
PËR PROJEKTE TË REJA, THIRRJA I PËR
VITIN 2017, GRANTI “ARSIMI”,
PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË
INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE
RAJONALE, SHTYLLA I**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 dhe të aneksit 3, të ligjit nr. 130, datë 15.12.2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja I për vitin 2017, për grantin “Arsimi”, programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, me burim financimi buxhetin e projekteve të reja për vitin 2017, nga programet buxhetore “Arsimi bazë” dhe “Arsimi i mesëm i përgjithshëm” pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të gjitha autoritetet kontraktuese, projektet e të cilave miratohen për financim sipas pikës 1, të këtij vendimi, brenda një jave nga data e publikimit të tij në Fletoren Zyrtare, duhet të paraqesin në Sekretariatit Teknik, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, kalendarin me të gjitha afatet e parashikuara për fazat e prokurimit publik dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit, si dhe të përdorimit të fondeve dhe emrin e personit përgjegjës për informimin periodik.

3. Autoritetet kontraktuese për projektet, sipas pikës 1, të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e punimeve të

ndërtimit, përpara fundit të tremujorit të dytë, të vitit 2017. Për fondet e projekteve të paprokuruar sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtën të rishqyrtojë financimin dhe t'i rishpërndajë ato për një projekt tjetër.

4. Ngarkohet Sekretariati Teknik, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, të kryejë monitorimin e ecurisë së përdorimit të fondeve, sipas kalendarit të paraqitur nga autoritetet kontraktuese, në përputhje me pikën 2, të këtij vendimi, dhe të informojë Ministrinë e Financave dhe periodikisht Komitetin për Zhvillimin e Rajoneve, përmes Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

5. Ngarkohen ministri i Financave dhe ministri i Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Edi Rama**

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.



Tabela 1 Lista e projekteve të reja, thirrja I për vitin 2017, granti “Arsimi”, programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, me cikël zbatimi 2017-2018

Nr	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2017 (në lekë)
QARKU BERAT				
1	Bashkia Ura Vajgurore	Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar “Refat Bani”	64 044 153	25 617 661
2	Bashkia Berat	Rikonstruksion i shkollës së mesme Starovë	52 710 346	26 355 173
3	Bashkia Kuçovë	Rikonstruksion i sheshit dhe fushave sportive tek shkollat “Gaqi Karakashi” dhe “28 Nëntori”	22 311 730	11 155 865
4	Bashkia Çorovodë	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Karaman Ylli”	63 397 640	25 359 056
QARKU DIBËR				
5	Bashkia Mat	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “31 Korriku”	74 183 197	29 673 279
6	Bashkia Klos	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Ramiz Kadiu”, Bejn	61 443 512	24 577 405
QARKU DURRËS				
7	Bashkia Durrës	Rikonstruksion dhe shtesë anësore dhe palestër e re në shkollën “14 Nëntori”	108 281 000	43 312 400
8	Bashkia Krujë	Rikonstruksion i shkollës së bashkuar dhe palestër Borizanë	74 157 568	29 663 027
QARKU ELBASAN				
9	Bashkia Elbasan	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Ali Agjahu”	57 413 301	22 965 320
10	Bashkia Peqin	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Gjocaj, ndërtim palestre dhe ambiente shërbimi shkolla Gjocaj	59 888 000	23 955 200
11	Bashkia Përrenjas	Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “Qybra Sokoli”	45 007 827	18 003 131
QARKU FIER				
12	Bashkia Fier	Rikonstruksion i shkollës artistike “Jakov Xoxa”	108 687 502	43 475 001
13	Bashkia Lushnjë	Rikonstruksion i kompleksit të shkollave Fier-Shegan (2 shkolla, palestër dhe terrene sportive)	99 154 307	39 661 723



14	Bashkia Lushnje	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare, Krutje	63 780 171	25 512 068
15	Bashkia Divjakë	Rikonstriksioni i shkollës “Koli Sako”, qyteti Divjakë	47 787 439	19 114 976
QARKU KORÇË				
16	Bashkia Korçë	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Abdulla Asabella”, Vincan	30 200 000	15 100 000
17	Bashkia Korçë	Rikonstruksion dhe shtesë e shkollës 9-vjeçare, Lumalas	16 700 000	8 350 000
18	Bashkia Maliq	Rehabilitim i shkollës 9-vjeçare Podgorie dhe rrijtëzimi i terreneve sportive të shkollës, N.J.A., Vreshtas	27 769 497	13 884 749
19	Bashkia Kolonjë	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare “Papa Kristo Negovani”, Ersekë	79 962 080	31 984 832
QARKU LEZHË				
20	Bashkia Kurbin	Rikonstruksion i godinës, palestrës dhe ambienteve sportive, shkolla 9-vjeçare “Gjin Pjetri”	99 000 002	39 600 001
21	Bashkia Lezhë	Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar Zejmen	45 844 310	18 337 724
22	Bashkia Mirditë	Rikonstruksion i konviktit të shkollës së mesme, Mirditë	39 752 494	15 900 998
QARKU SHKODËR				
23	Bashkia Shkodër	Rikonstruksion i pjesshëm i shkollës 9-vjeçare “Ura e Shtrenjtë”, Postrisë	7 105 224	5 000 000
24	Bashkia Pukë	Rikonstruksion i shkollës së mesme “Sabah Sinani”	32 308 340	12 923 336
QARKU TIRANË				
25	Bashkia Tiranë	Rikonstrukion i shkollës 9-vjeçare “Dora D’istria”	97 591 282	39 036 513
QARKU VLORË				
26	Bashkia Konispol	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare “Mehmet Xhaferri dhe kopësht	69 518 321	27 807 328
27	Bashkia Vlorë	Rikonstruksioni i shkollës së mesme “Halim Xhelo”	72 781 508	29 112 603
28	Bashkia Vlorë	Rikonstruksion i palestrës sportive të mbuluar, në shkollën fillore “Ismail Qemali”, Vlorë	22 302 105	13 520 632
29	Bashkia Himarë	Rikonstruksion i shkollës së mesme “Spiro Gjiku” dhe kthimi në objekt arsimor 9-vjeçar	52 600 000	21 040 000
TOTALI			1 695 682 856	700 000 000

**Shënim:**

1. “Vlera e projektit” përfaqëson vlerën e financimit për projektin, miratuar me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
2. “Vlera e financimit për vitin 2017” është financimi që jepet për vitin 2017, me burim fondin për projekte të reja, të programit buxhetor “Arsimi bazë” dhe “Arsimi i mesëm i përgjithshëm” të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për vitin 2017.
3. Likuidimi financiar për vlerën e projektit (ose për vlerën e kontratës pas prokurimit publik) në vitet në vazhdim do të kryhet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, duke u bazuar edhe në ecurinë e zbatimit dhe të realizimit të projekteve, programuar në buxhet, me shtrirje në 2 vite.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 140 lekë